



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Nenit 8 të Rregullores mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve nr. MF04/2017 si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 24.12.2021, Drejtoresha e DKRS shpallë:

THIRRJE PUBLIKE PËR OJQ

**1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve dhe
12 Qershorit – Ditës së Çlirimit 2026**

Bazuar në rregulloren e MF-NR-04/2017 mbi kriteret,standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve:

Drejtoriati për Kulturë,Rini dhe Sport bën thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës, e që veprojnë në Komunën e Lipjanit ,programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Fëmijëve,Kulturës, Rinisë dhe Edukimit të aplikojnë për mbështetje financiare për projektin: **1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve dhe 12 Qershorit – Ditës së Çlirimit 2026**

Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një project përmes aktiviteteve si më poshtë:

Objektivat:

- Argëtimin dhe edukimin e fëmijëve
- Promovimin e të drejtave të fëmijëve
- Nxitjen e kreativitetit dhe pjesëmarrjes aktive të fëmijëve dhe të rinjve
- Nderimin e vlerave të lirisë dhe përkujtimin e Ditës së Çlirimit

Aktivitetet:

- **Aktivitetet e propozuara për 1 Qershor duhet të realizohen më datë 1 Qershor**
- **Aktivitetet e propozuara për 12 Qershor duhet të realizohen më datë 12 Qershor**
- Punëtori kreative (art, muzikë, teatër, lexim)
- Aktivitete sportive dhe lojëra në natyrë
- Shfaqje artistike dhe kulturore për fëmijë dhe të rinj
- Aktivitete edukative dhe ndërgjegjësuere
- Lojëra ndërvepruese dhe aktivitete inovative për fëmijë
- Aktivitete përkujtimore, kulturore dhe edukative në kuadër të Ditës së Çlirimit

Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 5,000.00 euro.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo project është 501.00euro, ndërsa shuma maksimale për një project është 5,000.00 euro.

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me 30.04.2026.

OJQ-të mund të aplikojnë më së shumti me një (1) projekte në kuadër të kësaj thirrje,ndërsa periodha e zbatimit të projektit është 1 deri 30 ditë.

OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve të tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës,OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale.

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë,të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët,janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (web faqen www.komunaelipjanit-rks.org).

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht,në adresën e mëposhtme:

KOMUNA E LIPJANIT

Rruga „Shqipëria”

Zyra për Shërbim të Qytetarëve nr.1 dhe nr.2.

Procesi i pranimit,hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar Brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën (mergim.oruci@rks-gov.net)

Lipjan, më 08.04.2026



Burim Rrustemi
Drejtor i DKRS-së